



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:085713

Datë: 23.12.2024

Numri i dokumentit: 06638013

PAKR.nr.333/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri – Kryetar i kolegjit, Vatton Durguti dhe Skender Çoçaj - anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Gresë Latifi, në çështjen penale ndaj të pandehurit Gj.J për shkak të veprave penale: Vrasje në tentativë nga neni 146, e lidhur me nenin 20, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (tutje: KPPK); Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328, par. 1, të KPPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Gj.J av. I.M, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.48/2007 të datës 08.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK, me datë 11.09.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET si e bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit Gj.J av. I.M, ndërsa **ANULOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.48/2007 i datës 08.04.2024 dhe çështja i kthehet në rigjykim.

II. Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë është jolëndore.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.48/2007 të datës 08.04.2024, të akuzuarin Gj.J e ka shpallur fajtor për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 146, e lidhur me nenin 20, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (tutje: KPPK) dhe e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në dënimin e shqiptuar i është llogaritur edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 28.09.2006 deri me datë 07.12.2006.

I pandehuri është liruar nga shpenzimet e procedurës penale dhe të njëjtat kanë rënë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Palët e dëmtuara: A.K dhe A.K, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Në mbështetje të nenit 362, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3, të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje: KPP), gjykata e shkallës së parë ka refuzuar akuzën për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328, par. 1, të KPPK-së.

Shpenzimet e procedurës për këtë pikë janë mbuluar nga mjetet e kësaj Gjykate.

Kërkesë pasurore-juridike nuk pati për këtë pikë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës të aprovoj ankesën si të bazuar ashtu që ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar sa i përket vendimit mbi dënimin dhe ti shqiptoj akuzuarit dënim me burgim më të lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit Gj.J av. I.M, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj si të bazuar në tërësi ankesën ashtu që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të lirohet i akuzuari

për veprën penale Vrasje në tentativë ndaj A. dhe A.K apo që aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe vendosje të sërishme.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/L.nr.311/2024 të dt.11.06.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet sa i përket vendimit lidhur me sanksionin penal në mënyrë që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim me burgim më i lartë sesa me aktgjykimin e ankimuar, ndërkaq ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, në të cilën ka prezantuar mbrojtësi i të akuzuarit Gj.J av. I.M, përfaqësuesja e palës së dëmtuar A.K av. S.K si dhe përfaqësuesja e palës së dëmtuar A.K av. A.T.K, ndërsa nuk ka prezantuar askush nga palët tjera edhe pse të njëjtit kanë qenë të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt për mbajtjen e seancës.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, shkresat e lëndës, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK-së, vlerësoi pretendimet ankimore të paraqitura nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe mbrojtësi i të akuzuarit Gj.J av. I.M dhe pas analizimit dhe vlerësimit të tyre gjeti se: **Ankesa e mbrojtësit e të akuzuarit Gj.J av. I.M është e bazuar ndërsa ajo e prokurorisë tani për tani është jolëndore.**

Pretendimet ankimore

Në ankesë Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë konsideron se dënimi i shqiptuar me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj nga ana e gjykatës, ndaj të akuzuarit të lartcekur Gj.J. për veprën penale që i vihet në barrë nuk është adekuat me peshën e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit të lartcekur. Prokuroria më tej shton se shqiptimi i një dënimi të tillë nuk është adekuat me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, andaj e njëjta konsideron se me një dënim të tillë të cilin Gjykata ia ka shqiptuar të akuzuarit të lartcekur nuk do të arrihet qëllimi i dënimit, andaj mbi këto rrethana ka propozuar si më lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit Gj.J. av. I.M. në ankesë thekson se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje të dispozitave procedurale konsiston nga neni 384 par-2.1,2.5 dhe 2.7 i KPPRK, kjo për faktin se arsyetimi i aktgjykimit të atakuar është në kundërshtim me dispozitën e nenit 369.7 të KPPRK, si dhe nenit 364 par 1.1 dhe se nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë faktet dhe arsyet e vërtetuara me ato të pavërtetuara, saktësia e provave kundërthënëse dhe se në aktgjykimin e atakuar nuk janë përshkruar faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale. Aktgjykimi i atakuar mbështet në “provën” e cila fare s’është administruar si provë (as që është propozuar nga cilado palë), pra nuk bazohet në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, në kuptim të dispozitës së nenit 360 par.1 të KPPRK-së. Gjykata e shkallës së parë në faqen 12 pasusi 4 i aktgjykimit të atakuar pretendon se është bazuar në dispozitën e nenit 360 të KPPRK kurse me këtë dispozitë është përcaktuar se Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësorë. Është për t’u çuditur sepse me këtë mënyrë të arsytimit të aktgjykimit, vet gjykata e shkallës së parë e demanton vetveten se është bazuar vetëm në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor. Shkeljet procedurale kanë ndikuar drejtpërdrejtë në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike e që konsiston në atë se, sipas përshkrimit faktik në aktakuzë, e që është akceptuar në aktgjykim e atakuar, në fjalinë e parë pretendohet se i akuzuari Gj.J. pas një fjalosje me të dëmtuarit... ndërsa nga provat e administruara, dëgjimi i dëshmitareve të propozuar nga ana e prokurorisë, dëshmohej se ngjarjes nuk i ka paraprirë fjalosja paraprake por kanosja serioze nga ana e këtu të cilësuarit si i dëmtuar, A.K. Kjo ka qenë njëra prej fakteve të pa kontestuara e jo ato që numërohen në aktgjykimin e atakuar. A.K., këtu i cilësuar si palë e dëmtuar, i është drejtuar Gj.J, në lokalin publik, dil jashtë se të qes me shkelma... dhe atë vetëm për arsye se Gj.J është drejtuar për një shërbim, për të cilin i njëjti e ka hapur lokalin publik. Kjo kanosje as që është mohuar nga A.K e as serioziteti i kanosjes, dhe atë pa arsye. Edhe në dispozitiv pretendohet se i pandehuri armën e ka poseduar në shtëpi e jo në vendin e ngjarjes dhe se pretendimi se kjo armë është sekuestruar, nga gjykata e shkallës së parë, do të kishte “mbulesë” në vërtetimin për sekuestrim. Aplikimi i gabuar i së drejtës materiale (ligjit) konsiston na atë se gjykata e shkallës së parë është thirr në dispozitën e nenit 12 par.2 të KPRK-së duke e ri cilësuar rastin në drejtim të kësaj dispozite. Kjo dispozitë në fakt e përjashton veprën penale, pasi që për gjykatën e shkallës së parë ka ekzistuar vetëmbrojtja, konform kësaj dispozite, në të cilën është orientuar kjo gjykatë me ri-cilësim. Pra këtu kemi aplikimin e gabuar dhe jo të drejtë të ligjit (material) apo mos aplikimin e së drejtës materiale, në të cilën thirret vet Gjykata e shkallës së parë, si në dispozitiv ashtu edhe në arsyetim. Mbi këto rrethana ka propozuar si më lartë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, pasi analizoi aktgjykimin e ankimuar së bashku me shkresat e lëndës, duke i vlerësuar pretendimet ankimore, dhe sipas detyrës zyrtare, gjeti se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 pika 2.1 dhe 2.7 të ndërlidhura me nenin 360 të KPPRK-së, shkelje këto të cilat kanë ndikuar në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë, e për të cilat aktgjykimi i ankimuar juridikisht është i paqëndrueshëm dhe detyrimisht duhet anuluar.

Nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar rezulton se Gjykata e shkallës së parë, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit gjyqësorë ka konstatuar se ka administruar këto prova personale, gjegjësisht dëshmitarë A.K, A.K, V.K. dhe B.R., dhe materiale Raporti policor i njësisë së hetimeve në Prishtinë, datë 29.09.2006; Akt ekspertimi mjeko-ligjor i hartuar nga Dr. N.H, datë 01.12.2006; Raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me nr. AKF/2017-2155/2017-1931, datë 15.11.2017; Akt ekspertimi mjeko-ligjor, i datës 20.01.2024 për të dëmtuarin A.K, hartuar nga Dr. A.G, Dr. I.K, dhe Dr. V.H; Raporti për gjendjen e shëndetit mendor për të pandehurin Gj.J, i hartuar nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike, datë 14.11.2023, nga të cilat prova është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 146, e lidhur me nenin 20, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (tutje: KPPK) dhe konform nenit 364 të KPP-së të njëjtit i ka shqiptuar dënim me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Nga të konstatuarat si më lartë kjo gjykatë gjeti se janë të bazuara pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit Gj.J av. I.M se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ngase në faqen 4 pasusi i fundit i aktgjykimit të ankimuar gjykata numëron provat e administruara, nga i cili numërim shihet se nuk është administruar deklarata e të pandehurit e dhënë në Prokurori në të cilën është mbështetur aktgjykimi i atakuar (faqe 8 pasusi 5 i aktgjykimit të ankimuar ku konstatohet se: shumicën e tyre (faktet) i pranon edhe vet i pandehuri...) kurse në faqen e njëjtë, pasusi i parë dhe i fundit gjykata konstaton se: i pandehuri në deklarinimin e tij... kurse i pandehuri është mbrojtur në heshtje. Po ashtu në faqe 6 pasusi i fundit konstaton se i pandehuri në shqyrtimin gjyqësor është mbrojtur në heshtje ndryshe nga deklarimi në prokurori me dt. 04.10.2006... Tutje gjykata e

shkallës së parë në faqe 12 pasusi 4 të aktgjykimit të atakuar pretendon se është bazuar në dispozitën e nenit 360 të KPPRK-së kurse me këtë dispozitë përcaktohet decidivisht se; “Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor”. Ky kolegji penal i Gjykatës së Apelit rikujton se përkritazi me deklaratimet e të pandehurit në seancë të shqyrtimit gjyqësor duhet që të pandehurit të i rikujtohet se të njëjtat do të vlerësohen në tërësinë e provave, duke i lexuar apo konstatuar, në rastet kur i pandehuri në shqyrtimin gjyqësor mbrohet në heshtje.

Andaj, nga të lartcekurat qëndron pretendimi i ngritur nga mbrojtja si në ankesë se si mund gjykata të bazon aktgjykimin në diçka që nuk e ka administruar e madje një provë e tillë as nuk është propozuar nga palët, dhe kjo përbën shkelje e cila në fakt ka ndikuar në marrjen e aktgjykimit të drejtë dhe të ligjshëm ngase dispozita e nenit 360 par. 1 të KPPK-së përcakton se “Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor”, prandaj rrjedh padyshim se, në bazë të kësaj dispozite, gjykata është e obliguar që me rastin e vendosjes, aktgjykimin e saj ta bazoj vetën në faktet dhe provat të cilat janë proceduar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, kurse me shikimin e procesverbaleve të seancave të shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura shihet qartazi se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e ankimuar e ka mbështetur edhe në prova të cilat nuk i ka administruar gjatë këtyre seancave të shqyrtimit gjyqësor, e të elaboruara si më lartë.

Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se ashtu si me të drejtë thekson mbrojtja në ankesë, meqenëse aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase aktgjykimi i ankimuar është bazuar në prova të pa administruara në shqyrtim gjyqësor, e nga të cilat shkelje rezulton se të njëjtat kanë ndikuar në marrjen e aktgjykimit të drejtë, rrjedh se në këtë çështje penale edhe gjendja faktike të mos jetë vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë për faktet vendimtare dhe rrjedhimisht edhe mos zbatim të drejtë të ligjit penal.

Andaj, nga arsyet e sipër cekura aktgjykimi i ankimuar juridikisht është i paqëndrueshëm dhe si i tillë duhet të anulohet dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim për të cilat është e nevojshme që gjykata e shkallës së parë, të përsëris shqyrtimin gjyqësor për të administruar provat relevante të kësaj çështje penale pasi që në kuptim të nenit 403 të KPP-së, Gjykata e Apelit nga konstatimet e bëra lidhur me këto shkelje të lartcekura nga gjykata e shkallës së parë, nuk mund të korrigjoj duke ndryshuar aktgjykimin e kundërshtuar pasi që duhet përsëritur shqyrtimi gjyqësor, ku në rigjykim Gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim

me vërejtjet e lartcekura, t'i eliminoj të gjitha shkeljet e cekura, t'i administroj të gjitha provat, dhe të njëjtat t'i vlerësoj në pajtim me dispozitën e nenit 369 të KPP-së, dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave të nxjerr konkluzione të drejta dhe të ligjshme e të bazuara në provat e administruara e pastaj të merr vendim të drejtë dhe ligjor.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 402 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti për Krime të Rënda
PAKR.nr.333/2024, datë 11.09.2024

Bashkëpunëtore Profesionale,
Gresë Latifi

Anëtarët e kolegjit,
Vaton Durguti

Kryetar i kolegjit,
Zyhdi Haziri

Skender Çoçaj
